



**Prot. 2211/215 K (e-k)**

**Datë, 22 / 11 / 2022, Tiranë**

**Lënda:** Lidhur me Projektvendimin “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”!

**E Nderuar znj. Ballgjini!**

**Të nderuar kolegë të KQZ !**

Së pari më lejoni që në emër të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) t’ju kërkojmë ndjesë për vonesën në përgjigje të këtij emaili. Kjo, për shkak të angazhimeve dhe periudhës tepër të ngarkuar të KRIIK dhe nga ana tjetër edhe për shkak të një riorganizimi të plotë të informacionit të dalë si rezultat i monitorimit nga KRIIK për ta përshtatur sipas kërkesës suaj dhe të Komisionerit në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t’ua përcjellë më lehtë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike.

Në emailin e datës 2 nëntor KRIIK ka shprehur Qëndrimin e tij, veçanërisht atë në nivelin politik të çështjes, ku ndër të tjera thekson se i qëndron fort nevojës për domosdoshmërinë e adresimit të të gjitha shkeljeve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion zyrtarisht edhe Institucionit tuaj që në qershor 2022 (në formën e indicieve), përpos publikimit të tyre në Raportin Final të publikuar në shkurt 2022.

KRIIK vlerëson punën e bërë nga administrata e KQZ-së në hartimin e raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore në Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021, por gjykon se në të ka elementë të papërfshirë, ndryshe nga sa u deklarua në mbledhjen e datës 20.10.2022, ndërkohë që edhe për shkeljet e konstatuara dhe të përfshira në raport, KRIIK është i mendimit se mungon adresimi me një qasje të plotë proaktive të KQZ-së në zhvillim të përgjegjësive, rolit dhe kompetencave të cilat i janë dhënë nga ligjvënësi. *(në rast se konsiderohet me interes, KRIIK mund t’ua përcjellë me një email të veçantë konsideratat e tij për sa parashtrohen në këtë paragraf).*

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

KRIIK i qëndron fort dhe nxit KQZ-në për adresimin e shkeljeve jo vetëm ndaj partive politike, si subjekte juridike, por në rradhë të parë ndaj individëve nominalë të cilët

ushtrojnë funksione, detyra e përgjegjësi në shkelje të parashikimeve ligjore. Integriteti politik dhe institucional i partive politike është i lidhur pazgjidhshmërisht me integritetin politik e individual të funksionarëve, perfaqesuesve apo kandidatëve të tyre.

Konkretisht, **nevojitet që KQZ t'i shohë e për rrjedhim të sanksionojë, shkeljet e kandidatëve si përgjegjësi direkte të tyre** dhe jo si një shkelje e bërë nga partia politike përkatëse nën parashikimin ligjor të *një raporti jo në përputhje me formatin e miratuar*, i cili në gjykimin e KRIIK është i pavend.

Për më tepër që tërë kuadri ligjor dhe rregullat e raportimit financiar përcaktojnë qartë ndarjen veçmas të përgjegjësi midis partive politike dhe kandidatëve. Madje këta të fundit deklarojnë qartas në formularët e raportimit të tyre edhe përgjegjësitë që marrin përsipër nëpërmjet deklarimeve të bëra. (*Pjesa C – Deklarata, Formatin tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët në listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, Modeli i miratuar me vendim nr. 13 datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator*).

Po ashtu, **duhet të njihet mbajtja e përgjegjësisë veçanërisht nga financierët e partive politike** ndaj të cilëve ka role, procedura dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara nga kuadri ligjor, madje ata edhe janë trajnuar në vazhdimësi për këtë qëllim nga institucioni i KQZ-së dhe partnerë të tjerë.

Kandidimi i tyre në listat e kandidatëve të partisë përkatëse, nuk mund të anashkalohej ndërkohë që kjo është një kusht dhe kërkesë e prerë dhe e qartë nga kuadri ligjor.

Ndërsa përsa i përket **evidentimit të Zyrave Zgjedhore** që kanë funksionuar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, metodologjia dhe një informacion i plotë dhe i hollësishëm paraqitet në Raportin Final të Vëzhgimit të KRIIK.

Shkurtimisht, ju risjellim në vëmendje se përpos evidentimit në terren nëpërmjet vëzhguesve të KRIIK, është bërë shqyrtimi i çdo raporti të depozituar në KQZ, përfshirë të gjitha raportimet e depozituara prej kandidatëve të partive politike, pavarësisht vështirësisë në leximin e tyre.

**Veçojmë këtu se** në rastin e përmendjes së emrave të kandidatëve, të ndarë në parti të ndryshme brenda koalicionit PD-AN, kjo është bërë duke iu referuar siglës së partisë së vendosur për emrit të tyre në [listën e kandidatëve të publikuar në faqen e internetit të KQZ](#).

Po ashtu, tek raporti i vetëdeklarimit të LSI është deklaruar disa herë e njëjta zyrë zgjedhore, me gjasa për shkak të deklarimit sipas muajve të paguar, ndaj është llogaritur si e njëjta zyrë zgjedhore. Gjithashtu ky subjekt ka deklaruar si dhurim në natyrë zyra të

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

vëna në dispozicion nga 3 bashki (Berat, Pogradec dhe Mallakastër) të cilat eventualisht mund të jenë edhe zyra të partisë për degën përkatëse në këto bashki. Në përlogaritjet e KRIIK referuar vetëdeklarimit, këto zyra janë konsideruar si zyra zgjedhore, pasi kanë funksionuar si të tilla .

**Një tjetër mekanizëm kontrolli i përdorur për këto zyra ishte monitorimi i zbatimit të Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021** “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të KSHZ, sipas të cilit subjektet zgjedhore duhet të njoftonin Kryetarët e Bashkive si dhe vetë KQZ-në.

Ky rezultoi një detyrim thuajse i papërmbushur, pasi vetëm vetëm tri subjekte (PS, PD dhe LSI), nga dhjetë të evidentuara që kishin hapur zyra zgjedhore, njoftuan për hapjen e këtyre zyrave, por edhe këto vetëm në tetë bashki (Delvinë, Dropull, Elbasan, Krujë, Libohovë, Mat, Peqin dhe Përrenjas) .

Në total, nga shqyrtimi i tërë raporteve përfundimtare të monitorimit të depozituara në KQZ nga monitoruesit e KQZ-së rezultojnë 660 zyra zgjedhore të hapura nga subjektet zgjedhore, ndërkohë që për 35 prej tyre nuk është specifikuar se cilit subjekt i përket.

Ndërkaq, pas një rishikimi tërësor të gjetjeve, pas kërkesës suaj të datës 3 nëntor, duke shmangur dyshimet dhe pasaktësitë e mundshme, rezultoi se nga monitorimi në terren prej vëzhguesve të KRIIK, janë hapur 621 zyra zgjedhore në total. Ndërkaq sipas raporteve të vetdeklarimit të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve figurojnë në total 390 zyra zgjedhore, duke shënuar një diferencë akoma më të madhe, prej 231 zyrash zgjedhore të padeklaruara.

Në konkluzion, KRIIK është i mendimit se **Raporti i përgatitur prej KQZ-së duhet të përmbajë në mënyrë të plotë të gjitha shkeljet e vërejtura**, madje përfshirë rastet kur vetë KQZ është treguar tolerante, dhe më pas sigurisht që është në diskrecionin dhe kompetencën e institucionit të KQZ-së për të vazhduar me sanksionimin ose jo të subjekteve të gjetura në shkelje të kuadrit ligjor rregullator në fuqi.

Ndërsa përsa i përket gjetjeve të dala nga monitorimi i KRIIK që po ju përcjellim, theksojmë se ato janë riorganizuar në formë të tillë që të mund t’i shërbejnë qëllimit tuaj dhe për të lehtësuar punën tuaj për të vënë në dijeni subjektet zgjedhore garuese të 25 prillit 2021. Ndaj ato do t’ju nisen në emailë të veçanta për secilin subjekt zgjedhor, kjo për shkak edhe të volumit të lartë të të dhënave në disa raste.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Sjellim në vëmendjen tuaj, por edhe të subjekteve zgjedhore, se gjetjet janë produkt i një pune voluminoze të shqyrtimit të raporteve të vetdeklarimit të cilat, sikurse e dini, janë ato të publikuara në faqen e internetit dhe janë vështirësisht të lexueshme, duke qenë se asnjë subjekt zgjedhor nuk e solli këtë raportim në formatin e editueshëm “excel” sikurse parashikohet detyrimisht nga formatet e raportimit. Kjo do të thotë se nuk përjashtohet mundësia e gabimeve njerëzore, përsa iu përket sidomos shifrave të evidentuara e të kalkuluara, ndërkohë që qëllimi i të dhënave të nxjerra e dërguara mbetet ai i indicies për një verifikim më të thelluar dhe të plotë nga institucioni i KQZ-së.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

**Me konsideratë,**

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania